



Të dashur prindër

Shoqata Zvicerane e Shpëtimit të Jetës SLRG, ka qenë sot në kopshtin e fëmijës tuaj.

Një zhytës/e shpëtimit e SLRG si këshilldhënës/e, në bashkëpunim me edukatoret e kopshtit të fëmijëve, në formë loje, u ka treguar fëmijëve se si duhet të sillen në ujë dhe jashtë tij (njësoj sikurse këshillat e policit që u jepen fëmijëve për sjelljet në komunikacion).

Kjo vizitë në kopshtin e fëmijëve është pjesa më e rëndësishme e projektit të SLRG „Uji dhe unë“, i cili ka për qëllim shpjegimin e sjelljes së fëmijëve në ujë, në mënyrë që t'u iket aksidenteve. Në qoftë se dëshironi të dini më tepër rreth kësaj çështjeje, informata të mëtutjeshme mund të merrni në: www.das-wasser-und-ich.ch

Fëmija juaj sot ka mësuar 10 mënyra mbrojtjeje në ujë*. Për t'i përsëritur këto metoda, ata kanë marrë edhe nga një fletore vizatimi me vete.

Që të informoheni edhe ju për këto 10 metoda që i kemi zhvilluar, ju lutemi që t'u sqarojnë fëmijët tuaj.

Ne ju lutemi gjithashtu që ta përkrahni fëmijën në përmbajtjen e këtyre rregullave.

Për shembull keni mundësi që gjatë punës së përbashkët me përdorimin e vajit të diellit (mbrojtësit nga dielli), t'i përsëritni 10 këshillat e mbrojtjes në ujë.

Falënderime të përzemërta për përkrahjen tuaj

Anita Moser, udhëheqëse e projektit

*Këtu kemi patur mundësi të përdorim metodat e mësimit të mega memory® nga Gregor Staub (www.gregorstaub.com).

Këshilla në ujë të Picos

1

Mbrojtja nga dielli

- Unë lyhem me krem gjysëm ore përpara dhe gjatë drekës shkoj në hije

2

Tregoj ku ndodhem

- Unë i tregoj ku ndodhem personit që më shoqëron

3

Të ngrënit dhe të pirët

- Duhet patur kujdes në të ngrënë dhe në të pirë

4

Dushi

- Para larjes, shkoj në WC
- Unë bëj dush para larjes dhe ftoh trupin para larjes

5

Uji i cekët deri në bark

- Unë qëndroj në ujin e cekët deri në bark, derisa të mund të notojë mirë
- Gjatë notimit në distancë të madhe, kërkoj të më shoqërojë dikush

6

Loja ade

- Unë qëndroj në breg edhe në qoftë se lodra ime më e dashur më bie në ujë dhe është duke notuar mbi të

7

Veglat e shpëtimit

- Veglat e shpëtimit të përdoren vetëm në raste urgjente
- Unë shikoj ku ndodhen ato

8

Thirrje për ndihmë, nëse është e nevojshme

- Unë thërras për ndihmë vetëm në raste urgjente

9

Shiko, ku mund të kërcesh

- Unë kërcëj në ujë, vetëm në vendin që e njoh dhe nuk dëmtoj njeri

10

Tharja

- Unë e lë ujin nëse mërdhij
- Pas larjes duhet të thaheni mirë